



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Komisioni i Pavarur për Media

Raporti vjetor i punës
për vitin 2011

drejtuar

Kuvendit të Republikës së Kosovës

shkurt 2012

Telefoni: 038 245 031
Telefaksi: 038 245 034
Ueb faqja: www.kpm-ks.org
E-mail: info@kpm-ks.org

PËRMBAJTJA:

SHTOJCAT	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
BAZA LIGJORE.....	7
STRUKTURA E RAPORTIT	7
PJESA I.....	8
REALIZIMI I OBJEKTIVAVE TË KPM-SË PËR VITIN 2011	8
1. <i>Përcaktimi i politikës së kalimit në platformë digjitale të mediave elektronike të Kosovës</i>	8
2. <i>Zhvillimi i tregut medial që u shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës</i>	9
3. <i>Zhvillimi i politikave të transmetimit në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht</i>	10
PJESA II.....	10
OBJEKTIVAT PËR VITIN 2012	10
PJESA III.....	11
KËSHILLI I KPM-SË	11
<i>Përbërja dhe nominimet</i>	11
ORGANIZIMI I TAKIMEVE PUBLIKE	11
PJESA IV.....	12
PREZANTIM I PUNËS SË ZYRËS SË SHEFIT EKZEKUTIV	12
<i>Personeli</i>	12
DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZAVE	12
<i>Monitorimi i Pajtushmërisë me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore</i>	12
<i>Monitorimi i Pajtushmërisë me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuale</i>	13
<i>Monitorimi i programit të transmetuesit publik lidhur me Pajtushmërinë me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuale</i>	13
<i>Televizionet me mbulim nacional: TV 21 dhe KTV</i>	13
<i>Televizionet regjionale, lokale dhe OSHP-të</i>	13
<i>Monitorimi i Pajtushmërisë me Rregulloren për të Drejtën e Autorit</i>	14
<i>Pajtushmëria e RTK-së me nenin 6.6 të Ligjit për RTK-në</i>	14
<i>Monitorimi i Pajtushmërisë së Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio-vizuale me Pjesën 3 të Licencës së KPM-së</i>	14
<i>Monitorimet bazuar në ankesa</i>	15
<i>Vizitat/inspektimet tek ofruesit e shërbimeve mediave audio-vizuale</i>	15
DEPARTAMENTI I LICENCIMIT	15
<i>Njoftimi për pagesën e taksës për licencë</i>	16
DEPARTAMENTI LIGJOR	16
1. <i>Rastet për transmetim ilegal</i>	16
2. <i>Rastet për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuale KKPM 2009/04;</i>	16
3. <i>Rastet për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore CIMC 2009/01</i>	17
4. <i>Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës</i>	18
4.1. <i>Transmetimet pa të drejtë autoriale</i>	18
4.2. <i>Mos-mbajtja e arkivit</i>	18

4.3. <i>Shfrytëzim i Frekuencave pa autorizim të KPM-së.</i>	18
5. <i>Rastet për shkelje të Rregullores KKPM 2010/01 – Mospagesa e taksës për licencë</i>	18
6. <i>Raste dhe kërkesa tjera të proceduara nga KPM gjatë vitit 2011</i>	19
DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR	20
Analiza e Spektrit Frekuencor	20
<i>Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21)</i>	20
<i>Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova, Radio Blue Sky, Radio 21 dhe Radio Dukagjini)</i>	20
<i>Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regjional dhe lokal</i>	21
<i>Rastet për interferencë</i>	21
<i>Rastet për transmetime të palicencuara</i>	21
<i>Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare</i>	21
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE	21
<i>Buxheti</i>	21
PJESA V	23
PREZANTIMI I PUNËS SË BORDIT PËR ANKESA TË MEDIAVE (BAM)	23
<i>Seancat e BAM-it dhe Vendimet</i>	23
<i>Procesi i nominimit të anëtarit të tretë të BAM-it</i>	23
PJESA VI	24
BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE	24
BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE	24
SQARIM PËR SHKURTESAT E PËRDORURA	25

SHTOJCAT

- I. Raporti financiar për vitin 2011
- II. Raport Monitorimi – Pajtueshmëria e Shërbimeve Mediale Audio-vizuale me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore KKPM 2009/01
- III. Raport Monitorimi – Pajtueshmëria e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio-vizuale me Rregulloren për Komunikimet Komerciale KKPM 2009/04
- IV. Raport Monitorimi – Pajtueshmëria e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio-vizuale me të Drejtën Autoriale CIMC – 2009/03
- V. Raport Monitorimi – Pajtueshmëria e Subjekteve Transmetuese me Pjesën 3 të Licencës
- VI. Tabela e rasteve ligjore
- VII. Hartat e mbulueshmërisë së shërbimeve mediale audiovizuale nacionale dhe lokale/regjionale

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në përmbyllje të vitit të punës, Komisioni i Pavarur për Media (KPM), përmes zyrës së Shefit Ekzekutiv, përmbushë obligimin ligjor për t'i paraqitur Kuvendit të Republikës së Kosovës Raportin e Punës për vitin 2011.

Gjatë vitit 2011, KPM ka filluar punën me mungesë të pesë (5) anëtarëve të Këshillit të KPM-së, nga shtatë (7) sa parashihen me ligj. Në mungesë të organit vendim-marrës, KPM është ballafaquar me sfida dhe probleme serioze në arritjen e objektivave zhvillimore të përcaktuara për vitin 2011. Në mungesë të Këshillit të KPM-së, gjatë vitit 2011 KPM nuk ka mundur të marrë asnjë vendim që ndërlidhet me mandatin e saj rregullativ dhe në pajtim me politikat e transmetimit të përcaktuar me Ligjin e KPM-së.

Sidoqoftë, Zyra Ekzekutive e KPM-së, në pajtim me kompetencat e parapara me Ligj ka vazhduar bashkëpunimin me Kuvendin dhe organizmat tjerë relevante në amandamentimin e ligjit për KPM-në dhe atë të RTK-së, si dy prej ligjeve bazë në zhvillimin e sektorit medial në Republikën e Kosovës. Kontributi i KPM-së ka qenë i fokusuar ofrimin e komenteve të bazuara në direktivat dhe praktikat më të mira evropiane. Ky harmonizimin paraqitet si domosdoshmëri dhe parakusht drejt procesit të integrimi në Bashkimin Evropian.

Në frymën e bashkëpunimit me grupet punuese të themeluara, njëri nga Qeveria dhe tjetri nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, është arritur që të ndryshohet dhe të finalizohet Ligji për KPM-në duke e fuqizuar KPM-në në zbatimin e politikave mediale, konform standardeve evropiane.

Zyra Ekzekutive e KPM-së, në bashkëpunim me industrinë mediale dhe institucionet relevante, ka vazhduar punën përmes grupeve punuese në projektin me rëndësi nacionale – strategjinë për kalim në digjitalizim. Për të njëjtin proces për herë të parë nga KPM janë realizuar hulumtime gjithëpërfshirëse për tregun e reklamës, shikueshmërinë dhe penetrimin e mediave si dhe janë angazhuar ekspertë në cilësinë e konsulencës për çështjet teknike dhe ligjore të strategjisë. Pavarësisht progresit të arritur në draftet e punuara, nuk është bërë finalizimi i një dokumenti të konsoliduar sepse mungesa e Këshillit, i cili duhet të miratojë punën e Grupeve Punuese, ka ndikuar të ketë vonesa në realizimin e kësaj objektivë. Sidoqoftë, puna e grupeve do të vazhdojë në vitin 2012 me qëllim që drafti të jetë i përgatitur për t'ju prezantuar Këshillit të KPM-së për miratim, sapo të bëhet emërimi i anëtarëve nga Kuvendi.

Gjatë vitit 2011, Zyra Ekzekutive ka realizuar projekte të monitorimit të të gjitha subjekteve transmetuese me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së përmbajtjeve programore të tyre me kushtet dhe termet e përgjithshme të licencës si dhe akteve nënligjore të KPM-së. Për të gjitha gjetjet e shkeljeve që janë identifikuar nga monitorimi i programeve, Zyra Ekzekutive ka ndërmarrë masat ligjore sipas rregullave ligjore të procedurës. Gjatë fazës për të cilën raportohet, në KPM janë parashtruar kërkesa për frekuenca të lira, për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Programore dhe për licencimin e ritransmetimit të përmbajtjeve programore audiovizuale përmes sistemit IPTV (përmes internetit). Të gjitha rastet ligjore si edhe kërkesat që kanë të bëjnë me ndryshimin e kushteve të licencës apo kërkesave për licencime të reja, janë proceduar nga Zyra deri në fazën kur duhet t'u prezantohen për miratim organit vendim-marrës, Këshillit të KPM-së.

Zyra Ekzekutive operon me një personel prej 31 shërbyesish civil . Gjatë tërë vitit 2011, KPM është ballafaquar me vështirësinë që është shkaktuar nga përjashtimi i stafit civil të KPM nga përfitimi i rritjes së pagave për 30%, ashtu siç parashihet me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për shërbyesit civil. Pas shumë komunikimeve dhe takimeve zyrtare me përfaqësuesit e Ministrive

përgjegjëse për implementimin e këtij vendimi, Zyra Ekzekutive ka arritur që tek në muajin dhjetor të vitit 2011 të futet në skemën e rritjes së pagave për 30% për stafin e shërbimit civil.

E përmbyllim këtë përmbledhje të raportimit të punës së KPM-së me shpresën që në rrugëtimin e institucionit tonë drejt përmbushjes së misionit të përcaktuar me Ligj, i cili shpesh ballafaqohet edhe me sfida dhe vështirësi, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të vazhdojë mbështetjen dhe përkrahjen e vet. Në veçanti urojmë që KPM-së së shpejti t'i mundësohet funksionalizimi edhe në nivelin vendimmarrës duke emëruar anëtarët e Komisionit.

Roli dhe misioni i institucionit tonë është që të krijojë hapësirë për ngritjen e nivelit të lirisë së shprehjes, zhvillimin e një tregu të lirë medial si dhe llojllojshmëri mediale dhe ngritje profesionale, në shërbim të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Prandaj, për ta realizuar me sukses këtë mision, roli i Kuvendit është i pashmangshëm.

Sinqerisht,

Naile Selimaj Krasniqi
Shefe Ekzekutive
Komisioni i Pavarur për Media

BAZA LIGJORE

Më 21 prill 2005, Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Ligjin nr. 02/L-15 për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, i cili ka hyrë në fuqi më 8 shtator 2005.

Komisioni i Pavarur për Media është organ kushtetues i përcaktuar me nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Sipas nenit 3.8 të Ligjit për KPM-në, Këshilli i KPM-së përgatit dhe i paraqet Kuvendit të Kosovës, brenda dy muajve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, një raport vjetor duke përfshirë të dhënat e plota në lidhje me: përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave, procedimin e ankesave dhe sanksioneve të zbatueshme përfshirë edhe ekzekutimin e vendimeve në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera që kanë të bëjnë me rregullimin e transmetimit dhe përcaktimin e objektivave të projektuara për vitin e ardhshëm.

STRUKTURA E RAPORTIT

Raporti i punës së Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2011 pasqyron situatën në të cilën ka operuar KPM gjatë vitit 2011 pa funksionimin e organit vendimmarrës dhe prezanton punën e realizuar në nivelin e Zyrës Ekzekutive për arritjen e objektivave të përcaktuara për vitin 2011.

Raporti nuk është miratuar nga Këshilli i KPM-së në mungesë të kuorumit.

REALIZIMI I OBJEKTIVAVE TË KPM-SË PËR VITIN 2011

Për vitin 2011 janë planifikuar këto objektiva¹:

1. Përcaktimi i politikës së kalimit në platformë digjitale të mediave elektronike të Kosovës;
2. Zhvillimi i tregut medial që u shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe
3. Zhvillimi i politikave të transmetimit në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht.

1. Përcaktimi i politikës së kalimit në platformë digjitale të mediave elektronike të Kosovës

KPM në vitin 2010 ka filluar hartimin e strategjisë për kalim në sistemin digjital përmes grupeve punuese për çështje programore, ligjore, teknike, ekonomiko-shoqërore dhe për informim dhe sensibilizim.

Puna e grupeve ka vazhduar edhe në vitin 2011 me qëllim që të arrihet deri tek finalizimi dhe miratimi i kësaj strategjie nga Këshilli. Për rishikim të drafteve të iniciuara në vitin 2011 dhe për të siguruar që hartimi i strategjisë bazohet në praktika dhe standarde evropiane të aplikueshme në Republikën e Kosovës, Komisioni i Pavarur për Media ka angazhuar konsulentë ndërkombëtarë.

Grupi punues për çështje programore ka finalizuar draftin për pjesën e strategjisë që i dedikohet përmbajtjeve programore me të cilën janë përcaktuar standardet për përmbajtje programore gjatë kalimit nga transmetimi analog në digjital. Vëmendje e veçantë i është kushtuar definimit të kornizave themelore mbi përmbajtjet programore, varësisht nga lloji i transmetuesit që operon në Republikën e Kosovës dhe harmonizimit të programeve në pajtim me Direktivën e BE-së, përkatësisht Direktivën AVMS².

Grupi Punues për çështje ligjore ka vazhduar takimet në të cilat ka prezantuar draftin e pjesës ligjore të strategjisë për digjitalizim. Për shkak që nga anëtarët e GP është kontestuar vazhdimësia e punës në mungesë të përbërjes së plotë të Këshillit të KPM-së, i cili pastaj do të duhej të miratonte draftin për të qenë pjesë e strategjisë, finalizimi i pjesës ligjore mbetet të bëhet gjatë vitit 2012.

Për vazhdimësinë e punës së **Grupit punues për çështje teknike**, KPM ka prodhuar draftin me pasqyrim të disponueshmërisë së frekuencave digjitale dhe me rekomandime të cilat fokusohen në mundësitë për multipleksim nacional dhe regjional gjatë fazës transitore. Draftin ia ka prezantuar GP në takime për shqyrtim të mëtejshme. Është rekomanduar që të prezantohen edhe rrjetet regjionale me qëllim që të sigurohet operimi i mediave lokale e regjionale edhe pas shkyçjes së sistemit analog. Nga anëtarët e GP janë propozuar edhe disa opsione tjera por nuk është arritur tek përfundimet konkrete të cilat do t'i prezantohen Këshillit të KPM-së për miratim për të qenë pjesë e strategjisë. Finalizimi do të arrihet në pjesën e parë të vitit 2012. Problemi i Këshillit gjatë vitit

¹ Siç janë përcaktuar në raportin e punës së KPM-së për vitin 2010 (fq. 13):

<http://kpm-ks.org/materiale/dokument/1304587848.809.pdf>

² Direktiva AVMS (në gjuhën angleze Audiovisual Media Services Direktive) është Direktivë e BE-së për Shërbimet Mediale Audiovizuale

2011 ka afektuar edhe rezultatet e punës së GP teknik pasi që disa nga anëtarët e GP kanë kontestuar vazhdimësinë e punës në mungesë të Këshillit.

Me qëllim të ofrimit të të dhënave adekuate të nevojshme për **grupin punues ekonomik-shoqëror KPM** ka realizuar dy hulumtime³ me të cilat është bërë analizë e tregut të reklamës dhe vlerësimi i nivelit të shikueshmërisë dhe penetrimit të medieeve. *Lidhur me procesin e kalimit të transmetimit nga ai analog në atë digjital është me rëndësi të veçantë analizimi i tregut të reklamës për të gjitha mediat.*

Me hulumtimin për **Analizën e Tregut të Reklamës në Republikën e Kosovës** është bërë grumbullimi i të dhënave nga kompanitë private dhe publike lidhur me realizimin e planifikimeve buxhetore për reklamim si dhe identifikimin e tregut medial (p.sh. sa reklamohet në Televizione, në Radio dhe në Ofrues të Shërbimeve Programore). Në këtë hulumtim janë përfshirë shtatë regjione. Gjetjet nga hulumtimi tregojnë se 44% e buxhetit të kompanive publike janë planifikuar për reklamim në TV me mbulim nacional, 10% në TV me mbulim lokal, 8 % për radio me mbulim nacional, 9 % për radio me mbulim lokal; 11 % për gazeta ditore dhe 18 % për medime të tjera.

Me hulumtimin për **nivelin e shikueshmërisë dhe penetrimit të medieeve** janë vlerësuar kapacitetet ekzistuese që ofrojnë qasje në shërbimet mediale audio-vizuale në Republikën e Kosovës: numri i aparateve televizive në një familje, detajet dhe specifikat e TV aparateve në familje; lloji i pranimit të sinjalit televiziv (tokësor, kabllor, Satelit, IPTV etj). Hulumtimi ka ofruar një pasqyrë rreth numrit të përafërt të familjeve, për mënyrat e pranimit të sinjalit televiziv dhe të kapaciteteve aktuale të popullatës kosovare për pranim të sinjalit analog dhe atij digjital në të ardhmen.

Nga të gjeturat e hulumtimit mund të konstatohet se platforma kabllore dominon me një përqindje prej 49.2%, për dallim nga transmetimi tokësor që del se është 22.7 %. Ky rezultat paraqitet në këtë mënyrë për faktin që edhe pse ka mbulueshmëri me sinjal tokësor televiziv, shumica e familjeve kosovare tani përdorin sistemin kabllor përmes të cilit sistem marrin edhe sinjalet tokësore televizive të mediave të licencuara në Kosovë.

Gjendja reale e mbulueshmërisë me sinjal televiziv në nivel nacional është 62,7% kurse televizionet regjionale –lokale mbulojnë rreth 68.14% te territorit të Kosovës me sinjal. Këto të dhëna KPM i bazon në mbulueshmërinë për të cilën janë licencuar mediat nga vet KPM si edhe duke marrë në konsideratë matjet e vazhdueshme që bëhen në terren për verifikimin dhe vlerësimin e realizimit të kësaj mbulueshmërie.

2. Zhvillimi i tregut medial që u shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës

2.1 Lëshimi i licencave të reja në rrjetin analog - KPM ka vlerësuar se në disa lokalitete të Kosovës, qytetarët nuk kanë qasje të mjaftueshme në media të cilat do t’ju ofronin atyre informacione me karakter lokal apo të përgjithshëm. Bazuar në këtë, pas përfundimit të procesit të licencimit afatgjatë në vitin 2010 KPM ka bërë rishikimin e planit frekuencor analog dhe ka identifikuar frekuencat e lira, në ato zona⁴ ku ka vlerësuar se ekziston nevoja për sinjal radio-televiziv, për çka Komisioni i Pavarur për Media pati planifikuar që gjatë vitit 2011 të nxjerr në konkurs frekuenca të lira.

2.2 Licencimi i operatorëve kabllorë në veriun e Kosovës – Angazhimi për të licencuar operimet kabllore ilegale ka qenë e përcaktuar edhe me prioritetet KPM-së edhe në vitin 2011.

³ Raportet e dy hulumtimeve janë të postuara në webfaqen e KPM-së: www.kpm-ks.org

⁴ Prishtinë, Podujevë, Junik, Reçan, Kaçanik, Lipjan, Mitrovicë, Hani i Elezit

Të dy aktivitetet e paraqitura më lartë, të cilat kanë qenë të listuara përbrenda objektivave të KPM-së për vitin 2011 nuk kanë mundur të realizohen për arsye të mos-emërimit të anëtarëve të Këshillit të KPM-së. Kështu që, në mungesë të organit vendimmarrës (Këshillit të KPM-së), KPM nuk ka mund të marrë vendime për realizimin e këtyre obligimeve të përcaktuara.

3. Zhvillimi i politikave të transmetimit në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht

3.1 Rregullorja për operatorë kabllor - Gjatë vitit 2011 KPM ka punuar drejtë finalizimit të Draft rregullore për operatorët kabllorë. Ndryshime janë bërë kryesisht në aspektin e përmbajtjes së shërbimit kabllor, duke kërkuar nga operatorët kabllorë që shërbimet e tyre kablore të jenë në pajtueshmëri me Rregulloren e KPM-së për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore, të Drejtën e Autorit dhe kërkesën për transmetim të obligueshëm të sinjalit të shërbimeve mediale audio-vizuale (TV tokësore) të licencuara nga KPM-ja (must carry rule).

3.2 Rregullorja për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore – Gjithashtu gjatë vitit 2011, KPM ka punuar në harmonizimin e kësaj Rregulloreje me Ligjin për Kinematografinë. Ndryshimi është fokusuar në kohën e transmetimeve të programeve sipas kategorive dhe është harmonizuar me Ligjin për Kinematografi.

Këto draft rregullore fillimisht do të duhej të miratoheshin në parim nga Këshilli i KPM-së e pastaj të dërgohen për komente, në pajtueshmëri me praktikën e adaptimit të legjislacionit sekondar. Siç është cekur edhe më lartë, për arsye të përbërjes jo të plotë të Këshillit dhe pamundësisë së vendim-marrjes, draft rregulloret nuk janë aprovuar.

PJESA II

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2012

Me emërimin e anëtarëve të rinj të Këshillit të KPM-së, do të përcaktohen objektivat për vitin 2012.

Prioritet do të mbetet finalizimi i objektivave të vitit 2011.

PJESA III

KËSHILLI I KPM-SË

Përbërja dhe nominimet

Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media, si organ vendimmarrës, gjatë vitit 2011 në përbërje të vet ka pasur vetëm dy anëtarë nga shtatë (7) sa parashihet me Ligjin e KPM-së. Me këtë përbërje, respektivisht në mungesë të kuorumit, ka qenë e pamundur marrja e vendimeve për implementimin e politikave dhe rregullimit të transmetimit.

Mandati i katër anëtarëve të Këshillit të KPM-së ka kaluar me 15 dhjetor 2010.

Pas procesit të nominimeve⁵, KPM i ka përcjell Kuvendit listën e të nominuarve nga shoqëria civile më 1 tetor 2010, brenda afateve të përcaktuara me Ligjin e KPM-së. Me kërkesë të legjislaturës së re të Kuvendit të Republikës së Kosovës e njëjta listë është dërguar sërish më 21 mars 2011.

ORGANIZIMI I TAKIMEVE PUBLIKE

Në nëntor 2011 Komisioni i Pavarur për Media (KPM) ka organizuar konferencën me temën “Mbrojtja e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore”. Kjo konferencë është organizuar me asistencën teknike të Misionit të OSBE-së në Kosovë.

KPM në konferencë ka publikuar të gjeturat e raportit të monitorimit të Departamentit të Monitorimit dhe Analizave (DMA) lidhur me pajtueshmërinë e televizioneve dhe ofruesve të shërbimeve programore me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore.

Nga aspekti psikologjik, në mënyrë krahasuese për efektet e përmbajtjeve programore në zhvillimin e fëmijëve dhe të miturve ekspertë psikologë të kësaj lëmie kanë konkluduar se përmes transmetimit të programeve me përmbajtje të dëmshme programore, ndikohet negativisht në zhvillimin e fëmijëve dhe të miturve ku pasojat mund të jenë afatmesme dhe afatgjatë.

Përveç organizimit të konferencës KPM ka bërë edhe lansimin e spotit televiziv, spot ky i cili ka për qëllim të ndihmojë në vetëdijësimin e opinionit për ndikimin e përmbajtjeve të dëmshme programore në zhvillimin fizik, mental, emocional dhe moral të fëmijëve dhe të miturve.

⁵ Sipas ligjit Nr. 02/L15 respektivisht Neni 4.4 b) Zyra e Shefit Ekzekutiv me 8 shtator 2010 ka bërë ftesë publike për nominime për anëtarë të Këshillit të KPM-së

PJESA IV

PREZANTIM I PUNËS SË ZYRËS SË SHEFIT EKZEKUTIV

Personeli

Në fillim të vitit 2011, Zyra e KPM-së ka operuar me një staf prej 29 punëtorësh, ndërsa deri në fund të vitit 2011, numri i punëtorëve ka arritur në 31. Nga data 1 janar 2011 deri më 31 dhjetor 2011 është rekrutuar një (1) Zyrtar i Lartë për Monitorim Regjional dhe një (1) Asistent Ekzekutiv. Në Departamentin e Administratës përkatësisht në Divizionin e Financave një i punësuar është transferuar nga pozita e Zyrtarit të Lartë për Monitorim Regjional në pozitën e Zyrtarit të Lartë për Financa, kurse një (1) i punësuar ka dhënë dorëheqje nga posti i Zyrtarit të lartë për Financa.

Gjatë periudhës janar - dhjetor të vitit 2011 janë publikuar 2 shpallje dhe 1 rishpallje për këto vende të lira të punës: 1 shpallje për Zyrtar të Lartë për Monitorim Regjional, 1 shpallje për Asistent Ekzekutiv, dhe 1 rishpallje për Asistent Ekzekutiv.

DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZAVE

Në planveprimin e KPM-së për vitin 2011 është paraparë realizimi i projekteve të monitorimit lidhur me vlerësimin e pajtueshmërisë me:

- Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore,
- Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuale,
- Kushtet dhe Termet e Licencës, Pjesa 3,
- Rregulloren për të Drejtën e Autorit,
- Ligjin për RTK-në (Programet në Gjuhën e Minoriteteve),
- Vizita dhe Inspektime të gjithë Ofruesit të Shërbimeve Mediale.

DMA i ka realizuar të gjitha këto projekte brenda afatit të paraparë dhe për to janë përgatitur raporte përmbledhëse (shiko raportet në aneks).

Realizimi i këtyre monitorimeve i mundësoi Komisionit të Pavarur për Media krijimin e një pasqyre më të saktë për performancën e shërbimeve mediale audio-vizuale.

Monitorimi i Pajtueshmërisë me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore

Pajtueshmëria e shërbimeve mediale audio-vizuale me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore ishte projekti i parë i monitorimit i realizuar në vitin 2011, në të cilin janë përfshirë televizionet me mbulim nacional, regjional e lokal si dhe OSHP-të.

Të gjeturat nga këto monitorime kanë dëshmuar se edhe dy vjet pas nxjerrjes së kësaj rregulloreje, shumica e televizioneve dhe ofruesve të shërbimeve programore nuk respektojnë këtë Rregullore.

Shkeljet me të shpeshta të identifikuar me rastin e monitorimeve ishin ato për kategorizimin jo të duhur të përmbajtjeve programore, mosrespektimin e kohës për transmetim të programeve si dhe mos sinjalizimin dhe njoftimin paraprak për përmbajtjet programore, gjë që mund të ndikojë negativisht në zhvillimin fizik, mental, emocional dhe moral të fëmijëve dhe të miturve⁶.

Monitorimi i Pajtueshmërisë me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuale

Pajtueshmëria me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuale u realizua gjatë periudhës qershor-korrik të vitit 2011. Janë përfshirë në këtë monitorim televizionet nacionale, të gjitha televizionet regjionale e lokale si dhe 25 ofrues të shërbimeve programore (OSHP) të cilët transmetojnë komunikime komerciale.

Krahas gjetjeve për sasinë e reklamave të transmetuara brenda një ore program, monitorimet janë bërë edhe për vendosjen e produkteve, sponsorime dhe tele-shopping⁷.

Monitorimi i programit të transmetuesit publik lidhur me Pajtueshmërinë me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuale

Sipas Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuale KKPM 2009/04, Radio Televizionit të Kosovës (RTK) i përcaktohen kufizime në sasinë dhe kohën për transmetimin e komunikimeve komerciale audio-vizuale.

Më saktësisht, sipas nenit 15.2 të kësaj Rregullore, komunikimet komerciale audio-vizuale dhe spotet e teleshopingut në kanale të shërbyesit audio-vizual publik nuk mund të transmetohen prej orës 07:00 deri 09:00 dhe prej orës 18:00 deri në orën 23:00, ndërsa me nenin 19.1 ndalohet vendosja e produkteve tek transmetuesi publik.

Kjo prandaj ishte arsyeja që Departamenti i Monitorimit dhe Analizave, të monitorojë në vazhdimësi pajtueshmërinë e RTK-së me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuale. Gjetjet nga monitorimet e vazhdueshme kanë dëshmuar se edhe përkundër njoftimeve për shkelje, dhe vërejtjeve, Televizioni Publik i Kosovës ka vazhduar të transmetojë komunikime komerciale audio-vizuale në kundërshtim të plotë me Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audio-vizuale.

Televizionet me mbulim nacional: TV 21 dhe KTV

Në kundërshtim me këtë rregullore janë gjetur edhe dy televizionet tjera nacionale TV 21 dhe KTV, të cilat pas Njoftimeve për Shkelje dhe Vërejtjeve të KPM-së kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuale.

Televizionet regjionale, lokale dhe OSHP-të

Sipas monitorimeve të 19 televizione lokale e 25 OSHP të përfshira në këtë projekt, në shkelje të kësaj Rregulloreje janë gjetur: TV Festina, TV Men dhe TV Klan Kosova të cilat edhe pas Njoftimeve për Shkelje, Vërejtjeve dhe Urdhrave nuk kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren në fjalë.

⁶ Shih shtojcën II Raport Monitorimi - Pajtueshmëria e shërbimeve mediale audio-vizuale me rregulloren për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore.

⁷ Shih shtojcën III Raport Monitorimi - Pajtueshmëria e ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale me Rregulloren për Komunikimet Komerciale

Monitorimet lidhur me pajtueshmërinë me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuale janë bërë në vazhdimësi gjatë tërë vitit.

Monitorimi i Pajtueshmërisë me Rregulloren për të Drejtën e Autorit

Nga vlerësimi i pajtueshmërisë me këtë Rregullore është gjetur se shumë nga ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale kanë filluar të pajisen me marrëveshje për të drejtën e autorit, që dëshmon edhe për efektin pozitiv të monitorimeve dhe rekomandimeve të bëra të KPM-së për të vepruar në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Licencës – kapitulli mbi të drejtat e autorit.

Monitorimet lidhur me pajtueshmërinë me të drejtën e autorit janë bërë në vazhdimësi gjatë tërë vitit. Ato janë intensifikuar veçmas në periudhën e organizimit të kampionateve dhe ligave futbolistike gjatë vitit 2011⁸.

Pajtueshmëria e RTK-së me nenin 6.6 të Ligjit për RTK-në

Bazuar në praktikat evropiane, transmetuesit publik kanë obligime të qarta karshi publikut. Një prej obligimeve të RTK-së, që del nga Neni 6.6 i Ligjit për RTK-në, është transmetimi i programeve në gjuhët e minoriteteve.

Neni 6.6 i Ligjit për RTK-në- përcakton:

“RTK-ja iu shërben dhe u jep mundësi të shprehjes të gjitha komuniteteve etnike në Kosovë duke iu dedikuar jo më pak se 10% të buxhetit për programin e saj dhe jo më pak se 15% të skemës programore përfshirë kohën kryesore të mbulimit të lajmeve për komunitetet jo shumicë në gjuhën e tyre përkatëse në baza proporcionale”.

Pajtueshmëria e Televizionit Publik të Kosovës me Ligjin për RTK-në respektivisht nenin 6.6 të këtij ligji ishte prandaj theks i tri monitorimeve një javore lidhur me sasinë e programeve të transmetuara në gjuhën e minoriteteve në RTK. (ku hyjnë edhe Radio Kosova dhe Radio Blue Sky).

Monitorimi i bërë për periudhën 17-23 qershor 2011, ka dëshmuar se përkundër rritjes së sasisë së programit për minoritete nga **12.69% në 13.40%**, RTK në periudhën monitoruese nuk ka arritur pajtueshmëri të plotë me Nenin 6.6 të Ligjit për RTK-në.

Monitorimi i Pajtueshmërisë së Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio-vizuale me Pjesën 3 të Licencës së KPM-së

Departamenti i Monitorimit dhe analizave (DMA) në periudhën shtator - dhjetor 2011, ka realizuar monitorime, gjatë të cilave është bërë vlerësimi i pajtueshmërisë së ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale me Pjesën 3 të Licencës së KPM-së, i cili kishte për qëllim analizimin e formatit dhe strukturës programore të programit një javorë. Kjo i mundësoi DMA-së krijimin e një pasqyre të saktë për pajtueshmërinë e subjekteve transmetuese me skemën programore.

Është konstatim nga ky monitorim se përkundër disa ndryshimeve në formatin dhe strukturën e programit, ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale në periudhën monitoruese janë gjetur kryesisht në pajtueshmëri me Pjesën 3 të Licencës së KPM-së – Formatit i Programit.

⁸ Shih shtojcën IV Raport Monitorimi - Pajtueshmëria e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio-vizuale me të Drejtën Autoriale

Monitorimi i pajtueshmërisë së ofruesve të shërbimeve mediave audio-vizuale me Pjesën 3 të Licencës, ka dëshmuar gjithashtu se disa televizione lokale e OSHP kanë filluar t'i konsolidojnë programet e veta në mënyrë që segmenteve të ndryshme të audiencës së tyre t'ju ofrojnë diversitet programesh si: program të shërbimit publik dhe program argëtues, ashtu siç kanë deklaruar në skemat e tyre programore⁹.

Monitorimet bazuar në ankesa

Pas ankesave lidhur me shkeljet e mundshme nga ana e shërbimeve mediale audio-vizuale, DMA ka bërë monitorime të detajuara si dhe analiza të përmbajtjeve të apostrofuara, pas të cilave ka bërë rekomandime tek departamentet tjera.

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij Departamenti pas shqyrtimit të ankesave dhe realizimit të projekteve të monitorimit, ishin bazë, mbi të cilat, Departamentet tjera kanë mbështetur veprimet e tyre.

Vizitat/inspektimet tek ofruesit e shërbimeve mediave audio-vizuale

Stafi i Departamentit të Monitorimit dhe Analizave ka realizuar edhe vizita e inspektime tek të gjitha Radiot,Televizionet, Ofruesit e shërbimeve programore dhe operatorët kabllor të licencuara në KPM.

Vlen të theksohet se vizitat tek ofruesit e shërbimeve mediave audio-vizuale u mirëpritën dhe u cilësuan shumë të dobishme. U diskutuan gjatë tyre shumë çështje të cilat i shqetësojnë shërbimet mediale audio-vizuale dhe u shpалosën tema me interes për të dy palët.

DEPARTAMENTI I LICENCIMIT

Gjatë vitit 2011 Departamenti i Licencimit ka regjistruar 32 raste si: kërkesa për licencë të OSHP-ve, kërkesa për kanal televiziv, kërkesa për frekuencë të radios, ankesa për ndërhyrje në frekuencë, kërkesa për ndryshim të zonës së mbulimit, kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit, njoftim të ndërprerjes së transmetimit etj.

- 7 kërkesa për frekuencë të radios;
- 2 kërkesa për TV kanale;
- 8 kërkesa për licencë të OSHP-ve;
- kërkesa për licencë të Operatorëve Kabllorë;
- kërkesë për IPTV ;
- kërkesë për bartje të sinjalit të programeve të OK përmes „Eireless“;
- kërkesë për zgjerim të zonës së mbulimit;
- kërkesë për ndryshim të lokacionit të transmetimit;
- kërkesë për ndryshimin e emrit të OSHP-së;
- njoftim për transmetim ilegal;
- njoftime për heqje dorë nga licenca;
- njoftime për ndërprerjen e transmetimit;
- ankesa për ndërhyrje në frekuencën e transmetimit.

9 Shih shtojcën V Raport Monitorimi – Pajtueshmëria e Subjekteve Transmetuese me Pjesën 3 të Licencës

Për shkak të mungesë së anëtarëve të Këshillit këto kërkesa nuk kanë mundur të procedohen për shqyrtim para Këshillit.

Njoftimi për pagesën e taksës për licencë

Departamenti i Licencimit për vitin 2011 ka përcjell shkresat në formë të njoftimit të subjekteve transmetuese rreth afatit të pagesës së taksës për licencë duke iu theksuar edhe shumën për pagesë.

Për shkak të vështirësive financiare, gjatë vitit 2011 kanë heq dorë nga licenca e KPM-së 2 subjekte transmetuese dhe 1 ofrues i shërbimeve programore.

DEPARTAMENTI LIGJOR

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2011, ka shqyrtuar raste të ndryshme të subjekteve transmetuese, ofruesve të shërbimeve programore dhe operatorëve kabllorë për shkelje të dispozitave të Ligjit 02/L-15 për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetimin dhe akteve tjera nënligjore të KPM-së. Gjithashtu janë shqyrtuar edhe ankesa ndaj mediave elektronike që i janë drejtuar KPM-së nga persona fizik dhe organizata të ndryshme.

1. Rastet për transmetim ilegal

Gjatë vitit 2011, janë proceduar katër (4) raste për shkeljen e nenit 11.1 të Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se: *“Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij Ligji kërkohet licenca për transmetim të cilin e lëshon Komisioni”*, dhe neni 20.5 i Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se: *“Kushdo që operon pa leje transmetimi valide, i konfiskohet aparatura përkatëse për transmetim. Subjekti i tillë nuk mund të ankohet tek Bordi i Ankesave për Media”*.

Rastet e proceduara për shkeljen e dispozitave të lartpërmendura janë paraqitur në tabelën 1 të shtojcës VI¹⁰ të këtij raporti dhe kanë të bëjnë me një (1) subjekt ilegal transmetues në regjionin e Gjakovës. Edhe pas dërgimit të Urdhrit për ndërprerje të transmetimit ilegal, subjekti transmetues ilegal i quajtur Radio Pandora nuk ka ndërprerë transmetimin e programeve edhe pas revokimit të licencës nga Këshilli i KPM-së më datën 2 mars 2010. Më 11 janar 2011, BAM-i ka vërtetuar vendimin e Këshillit të KPM-së për konfiskimin e pajisjeve. Rasti është mbyllur.

Gjithashtu janë proceduar edhe tri raste të tjera për operim ilegal të tre (3) operatorëve kabllorë të cilët operojnë pa licencë. Departamenti Ligjor i KPM-së i ka dërguar shkresa të tre operatorëve kabllor duke i udhëzuar të aplikojnë për licencë në KPM. Disa operator kanë aplikuar për licencë mirëpo por në mungesë të Këshillit të KPM-së për t'i licencuar këta operator rastet barten për vitin 2012.

2. Rastet për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuale KKPM 2009/04;

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2011, ka proceduar tetëmbëdhjetë (18) raste kundër subjekteve transmetuese dhe ofruesve të shërbimeve programore që janë gjetur në shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-Vizuale KKPM 2009/04.

¹⁰ Tabela e rasteve ligjore

- RTK ka bërë shkelje të nenit 15.1 për vendosje të produkteve dhe nenit 15.3 të kësaj rregulloreje, për tejkalim të minutazhit të lejuar për reklamim. Pas Njoftimit për Shkelje, Vërejtjes me shkrim Urdhrit, dhe Vendimeve të Këshillit RTK ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren në fjalë. Këshilli i KPM-së duke u bazuar në shkeljet e vazhdueshme të Rregullores KKPM 2009/04, nga ana e RTK-së me datën 28 shtator 2010, ka sanksionuar me gjobë transmetuesin publik. RTK ka parashtruar ankesë kundër vendimeve të Këshillit të KPM-së në Bordin për Ankesa të Mediave (BAM). BAM-i ka hedhur poshtë ankesat e RTK-së si të pa baza dhe ka vërtetuar vendimet e Këshillit të KPM-së si të ligjshme. RTK edhe pas vendimeve të BAM-it me të cilat janë vërtetuar vendimet e Këshillit ka vazhduar të mos e respektoj Rregulloren KKPM-2009/0, më të cilat është obliguar në pagesën e gjobave.
 - KLAN KOSOVA, ka bërë shkelje të nenit 15.3 të kësaj rregulloreje, tejkalim i minutazhit të lejuar për reklamim. Pas pranimit të Njoftimit për Shkelje, Vërejtjes me shkrim dhe Urdhrit ofruesi i shërbimeve programore Klan Kosova nuk ka ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren *KKPM 2009/04*.
 - TV OPINION, ka bërë shkelje të nenit 15.3 të Rregullores KKPM 2009/04, i cili përcakton minutazhin e lejuar për reklamim. Edhe pas pranimit të Njoftimit për Shkelje, Vërejtjes me shkrim dhe Urdhrit subjekti transmetues TV Opinion ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Rregulloren *KKPM 2009/04*.
 - TV FESTINA, ka bërë shkelje të nenit 15.3 të Rregullores KKPM 2009/04, i cili përcakton minutazhin e lejuar për reklamim. Edhe pas pranimit të Njoftimit për Shkelje, Vërejtjes me shkrim dhe Urdhrit subjekti transmetues TV Festina ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Rregulloren *KKPM 2009/04*.
 - TV MEN ka bërë shkelje të nenit 15.3 të Rregullores KKPM 2009/04, i cili përcakton minutazhin e lejuar për reklamim. Edhe pas pranimit të Njoftimit për Shkelje subjekti transmetues TV Men ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Rregulloren *KKPM 2009/04*.

Departamenti Ligjor ka proceduar me rastet e lartpërmendura duke i ndjekur të gjitha procedurat ligjore për t'i sjell në pajtueshmëri të licencuarit të cilët kanë vepruar në shkelje të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së. KPM ka përgatitur rekomandimet për sanksionim mirëpo në mungesë të përbërjes së plotë të Këshillit të KPM-së këto raste nuk kanë mund të përfundohen. Rastet bartën për procedim të mëtutjeshëm për vitin 2012.

Ndërsa 13 rastet tjera pas Njoftimit për Shkelje dhe Vërejtjes me Shkrim të dërguar nga ana e KPM-së kanë ardhur në pajtueshmëri me rregulloren. Rastet janë mbyllur.

3. Rastet për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore CIMC 2009/01

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2011, ka proceduar njëzet e tre (23) raste kundër subjekteve transmetuese dhe ofruesve të shërbimeve programore që janë gjetur në shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore 2009/01:

Pesë prej këtyre rasteve të cilat janë subjekte transmetuese, Zyra e KPM-së u ka dërguar Njoftim për Shkelje, Vërejtje me shkrim, si dhe Urdhër me ç`rast palët nuk kanë ardhur në pajtueshmëri. Rastet barten për vitin 2012.

Ndërsa 18 rastet tjera pas Njoftimit për Shkelje dhe Vërejtjes me Shkrim kanë ardhur në pajtueshmëri me rregulloren. Rastet janë mbyllur.

4. Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës

4.1. Transmetimet pa të drejtë autoriale

Edhe gjatë vitit 2011, çështja e respektimit të së drejtës autoriale ka qenë problem kyç si për industrinë mediale ashtu edhe për rregullatorin. Mungesa e një institucioni përkatës për zbatimin e Ligjit mbi të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta i cili është shpallur në gusht të vitit 2006, vështirëson edhe më shumë punën e KPM-së pasi që edhe gjatë vitit 2011 vetëm KPM është marr me çështjet e respektimit të së drejtës autoriale nga subjektet transmetuese.

Subjektet transmetuese së bashku me operatorët kabllorë dhe ofruesit e shërbimeve programore e kanë obligim sipas Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së që të respektojnë të drejtën e autorit dhe të sigurojnë kontrata valide për transmetimin dhe ritransmetimin e të gjitha e programeve.

- Për shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës janë iniciuar raste ndaj dhjetë (10) subjekteve transmetuese operatorëve kabllorë dhe ofrues vetë shërbimeve programore ndër të cilat janë: Kujtesa Net, K Film 2, IPKO, OK Eagle, Radio Kolasin, RTV Mir, TV Syri Vizion, TV Prizreni, Klan Kosova, TV Dukagjini cilat pas dërgimit të Njoftimeve për Shkelje dhe Vërejtjeve me shkrim janë mbyllur si raste, pasi që palët kanë ardhur në pajtueshmëri.

4.2. Mos-mbajtja e arkivit

Dështimi i Palëve Përgjegjëse për sjelljen e materialit të arkivuar programor sipas kërkesës së KPM-së, ka rezultuar me iniciimin e një (1) rasti ligjor, ndaj Radio Dodonës. Pas pranimit të Njoftimit për Shkelje, pala ka ardhur në pajtueshmëri, kështu që rasti është mbyllur.

4.3. Shfrytëzim i Frekuencave pa autorizim të KPM-së.

Gjatë vitit 2011 është gjetur një (1) rast Radio Bambus i cili ka vepruar në kundërshtim me nenin 6.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës duke e shfrytëzuar frekuencë në mënyrë të paautorizuar.

5. Rastet për shkelje të Rregullores KKPM 2010/01 – Mospagesa e taksës për licencë

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2011 ka proceduar tetëdhjetë e gjashtë (86) raste lidhur me këtë shkelje:

Për 40 subjekte transmetuese dhe ofrues të shërbimeve programore, Zyra e KPM-së u ka dërguar Njoftim për Shkelje, Vërejtje me shkrim, si dhe Urdhër me të cilën ju ka bërë me dije këtyre subjekteve se mos-pagesa e mëtejme e taksës për licencë do të rezultojë me revokim të licencës. Pas shtjerrës se mjeteve të brendshme juridike nga ana e Zyrës së KPM-së 23 rastet për mos pagesë të taksës janë përcjell në Gjykatën Ekonomike për ekzekutim.

Pas pranimit të Njoftimit për Shkelje, Vërejtjes me shkrim si dhe Urdhrit 46 subjektet tjera kanë bërë pagesën e taksës për Licencë, kështu që rastet janë mbyllur.

6. Raste dhe kërkesa tjera të proceduara nga KPM gjatë vitit 2011

Janë proceduar gjashtë (6) raste bazuar në ankesat e personave fizik dhe organizatave të ndryshme

- Rasti i parë është proceduar bazuar në ankesën e një personi fizik ndaj OSHP Rrokum TV, për mos dhënie të drejtës për reagim dhe korrigjim. KPM i ka dërguar shkresë palës ankuese duke e informuar se Rrokum Tv nuk ka bërë shkelje të nenit 12.1 të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio Vizuale KKPM 2010/01. Rasti është mbyllur.
- Rasti dytë, është proceduar bazuar në ankesën e një subjektit politikë ndaj subjekti transmetues KTV, në ankesë janë ngritur disa shqetësime dhe një sërë publikimesh të deformuara ndaj palës ankuese. Pas vlerësimit të ankesës KPM ka njoftuar palën ankuese se subjekti transmetues KTV nuk ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio Vizuale KKPM 2010/01. Rasti është mbyllur.
- Rasti i tretë, është proceduar bazuar në ankesën e Zyrtarit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ndaj subjekti transmetues KTV, për shkak të paraqitjes së një raporti nga ana e KTV-së ku KTV nuk ka bërë hulumtim të nevojshëm lidhur me transmetimin e materialit. Pas vlerësimit të ankesës KPM ka njoftuar palën ankuese se subjekti transmetues KTV nuk ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio Vizuale KKPM 2010/01. Rasti është mbyllur.
- Rasti i katërt është proceduar bazuar në ankesën e një personi fizik kundër subjektit transmetues RTK. Në ankesë ceket se RTK ka transmetuar dy kronika në programin e mëngjesit dhe në lajmet qendrore duke e akuzuar palën ankuese se ka qenë e përfshirë në afëra mashtrimi dhe shpërdorimi financiar në Institutin KIJAC. Pas vlerësimit të ankesës KPM ka konstatuar se RTK ka bërë shkelje të nenit 2.2,3.1, 5.3 dhe 5.7 të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio Vizuale KKPM 2010/01 dhe me këtë rast, KPM i ka dërguar shkresë RTK-së që brenda tri ditëve të bëjë korrigjimin e lajmeve të prezantuara në programin e mëngjesit dhe në lajmet qendrore. Rasti është mbyllur.
- Rasti i pestë, është proceduar bazuar në ankesën e Institutit KIPRED ndaj subjektit transmetues RTK. Në ankesë është cekur se RTK ka transmetuar informacion të pasaktë dhe të pavërtetë duke shpifur dhe mohuar pjesërisht të drejtën për reagim. Pas vlerësimit të ankesës KPM ka konstatuar se RTK ka bërë shkelje të nenit 2.1,3.1,4.1,12.1 dhe 12.2 të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio Vizuale KKPM 2010/01 dhe me këtë rast, KPM i ka dërguar shkresë RTK-së. Rasti është mbyllur.
- Rasti i gjashtë, është proceduar bazuar në ankesën e një personi fizik ndaj një gazetari të emisionit Drejtësia në Kosovë që transmetohet në RTK. Pas vlerësimit të ankesës KPM ka konstatuar se për shkak të kalimit të afatit zyrtar prej 21 ditësh brenda të cilit subjektet transmetuese janë të obliguara të mbajnë arkivin e programeve të transmetuara e ka pasur të pamundur shqyrtimin e ankesës së palës ankuese. KPM i ka dërguar shkresë palës ankuese duke e informuar se për arsye të kalimit të afatit zyrtar prej 21 ditësh dhe në mungesë të materialëve të transmetuara nuk mund të procedohet me tutje me ankesën. Rasti është i mbyllur.

DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR

Analiza e Spektrit Frekuencor

Në periudhën prill - korrik të vitit 2011, janë monitoruar radio televizionet nacionale, radio televizionet regjionale e lokale me qëllim të verifikimit të pajtueshmërisë së zonës së mbulimit me pjesën e dytë dhe të katërt të Licencës.

Gjithashtu, janë monitoruar edhe frekuencat radio e televizive që shfrytëzojnë KFOR-i, UNMIK-u dhe radio stacionet e huaja ndërkombëtare për nevojat e tyre.

Të dhënat nga kontrollat dhe matjet dëshmojnë se shfrytëzimi i spektrit frekuencor në territorin e Kosovës vazhdon të mbetet përafërsisht i njëjtë në krahasim me situatën në vitin 2010, me përjashtim të numrit të madh të sinjaleve radio dhe TV që vijnë nga vendet fqinje (Serbia, Maqedonia dhe Shqipëria).

Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21)

Nga matjet në teren dhe analizat e bëra, vërtetohet se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV dhe radio të subjekteve transmetuese nacionale është e një kualiteti shumë të mirë dhe e pa ndërferuar për ato lokacione që i mbulojnë dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë dhe të katërt të licencës. Megjithatë, duhet të theksohet përsëri edhe pse dihet nga raportet e mëhershme se mbulimi i tërësishëm i territorit të Kosovës nuk është i kënaqshëm, sepse mbulohet vetëm me 62,7% me sinjal televiziv, derisa regjione të tëra si Dragashi, Kaçaniku, Zhupa, Kamenica, Klina, Nova Bërda, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi kanë mbetur jashtë zonës së mbulimit me sinjal televiziv për shkak të problemit të vazhdueshëm të mos aktivizimi i pikës së lartë të Goleshit për transmetim primar televiziv si dhe mos aktivizimi i rrjetit sekondar (rrjeti i përsëritësve televiziv) për mbulim sekondar. Për këtë situatë KPM në vazhdimësi ka informuar organet më të larta shtetërore të Republikës së Kosovës, me theks të vecantë në rëndësinë e aktivizimit të kësaj pike për transmetim televiziv.

Aktualisht pika e lartë e Goleshit përdoret vetëm nga KFOR-i për transmetime radio FM dhe për të siguruar mbulueshmëri më të madhe me sinjal televiziv është shumë e rëndësishme që kjo pikë të aktivizohet edhe për subjektet transmetuese televizive. Maja e Goleshit është e regjistruar në ITU respektivisht në të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që nga Stokholm 61, Gjeneva 84, 89 dhe e fundit Gjeneva 2006, si pikë kryesore e transmetimit për Kosovën dhe për këtë arsye janë të rezervuara dhe të pranura ndërkombëtarisht kanale transmetimi radio e televizive me fuqi të mëdha rrezatimi. Me aktivizimin e kësaj pike të lartë të Goleshit për transmetim televiziv, do të rritej zona e mbulimit nga 62.7% (me nivel të sinjalit të kënaqshëm prej 60 dBuV/m) deri me 80% të territorit të Kosovës, do të mundësohej zhvillimi i rrjetit sekondar dhe do të arrihej që mbi 90% e territorit të Kosovës të mbulohet me sinjal televiziv kualitativ.

Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova, Radio Blue Sky, Radio 21 dhe Radio Dukagjini)

Mbulimi i territorit të Kosovës me sinjale radio FM nga subjektet transmetuese (Radio Kosova, Radio Blue Sky, Radio 21 dhe Radio Dukagjini) është rreth 90 % e territorit, me nivel të sinjalit të kënaqshëm, me përjashtim që në disa lokacione të vendit (segmente të caktuara rrugore me relief kodrinor) kualiteti dhe niveli i sinjalit është i dobët.

Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regjional dhe lokal

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra vërtetohet se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV dhe radio të subjekteve transmetuese është e një kualiteti shumë të mirë dhe e painterferuar për ato lokacione që i mbulojnë dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë dhe të katërt të licencës. Televizionet regjionale – lokale mbulojnë rreth **68.14%** të territorit të Kosovës me sinjal televiziv. ndërsa radiot lokale/regjionale mbulojnë rreth **96.98%** të territorit të Kosovës.

Më poshtë në vijim është e pasqyruar harta e mbulimit me sinjal të televizioneve regjionale-lokale në tërë territorin e Kosovës¹¹.

Rastet për interferencë

Gjatë vitit 2011 DMF, ka pranuar vetëm dy ankesa për interferencë nga subjektet transmetuese. Raportet e detajuara lidhur me këto dy ankesa rezultojnë në atë se nuk ka pasur interference në frekuencat e subjekteve transmetuese që janë ankuar:

- Radio Blue Sky, interferuar nga Radio Klan (Shqipëri) rajoni i Prizrenit.
- Radio Vala Rinore, interferuar nga Radio DW, ku pas matjeve është konstatuar që ka probleme për brenda transmetuesit e nuk interferohet nga jashtë.

Rastet për transmetime të palicencuara

DMF ka proceduar vetëm më rastin lidhur me subjektin transmetues TV Most nga Zveçani i cili edhe pse është i licencuar nga KPM-ja të transmetoj vetëm në kanal 61 ka filluar transmetimin e programit në mënyre ilegale edhe në dy kanale të tjera televizive, në kanal 38 dhe 56. KPM ka ndërmarrë veprime ligjore duke njoftuar zyrtarisht TV Most se shfrytëzimi i kanaleve 38 dhe 56 është ilegal dhe ka udhëzuar të ndërpresë transmetimin në këto kanale.

Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare

DMF gjatë vitit 2011 ka bërë edhe monitorime të frekuencave radio dhe televizive që janë në shfrytëzim të KFOR-it, UNMIK-ut dhe radiostacioneve të huaja ndërkombëtare (DË, BBC dhe Zëri i Amerikës) me qëllim të azhurnimit të bazës së të dhënave që posedon KPM-ja.

Frekuencat që i përdor KFOR-i, UNMIK-u dhe radiostacionet e huaja ndërkombëtare, nuk i janë nënshtruar procesit të licencimit afatgjatë dhe si të tilla mund të paraqesin interference në të ardhmen për shkak të mos instalimit të filtrave dalës.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE

Buxheti

Komisioni i Pavarur për Media është organizatë buxhetore e financuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Për vitin 2011, KPM-së i është ndarë buxhet prej 901,939.00 Euro duke përfshirë të hyrat vetanake prej 212,000.00 Euro dhe investimin kapital prej 450,000.00 Euro.

¹¹ Në shtojcën VII të raportit janë dhënë hartat e mbulueshmërisë për kategoritë radio dhe TV në nivel nacional dhe TV në nivelin lokal/regjional.

Për periudhën janar-dhjetor 2011, Komisioni i Pavarur për Media ka realizuar buxhetin për 55%,

Buxheti i Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2011				
Kategoritë	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i pashpenzuar
Pagat dhe mëditjet	191,169	225,169	224,456	713
Mallra dhe Shërbime	243,270	240,270	237,142	3,128
Shërbime Komunale	17,000	20,500	18,495	2,005
Shpenzimet Kapitale	450,000	450,000	8,120	441,880
Të Hyrat		212,000	138,288	73,712
Total:	901,939	1,147,939	626,501	521,438

Nga të hyrat vetanake të mbledhura prej taksës së licencës nga subjektet transmetuese janë gjeneruar 256,333.74 Euro. Me Marrëveshjen e Memorandum Mirëkuptimit në mes MF dhe KPM për shfrytëzimin e mjeteve nga taksa e licencës janë ndarë 212,000.00 Euro apo 82.7 %. Qëllimi i marrëveshjes për shfrytëzimin e të hyrave vetanake ka qenë për financimin e aktiviteteve për realizimin e projektit të hartimit të strategjisë për kalimin nga sistemi analog i transmetimit në sistemin digjital.

Gjatë ekzekutimit të vendimeve sanksionuese të Këshillit të KPM-së, janë mbledhur 50,000.00 Euro nga gjobat e paguara. Mjetet nga gjobat shkojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës, në pajtueshmëri me Nenin 20.4 të Ligjit për KPM-në.

Për vitin 2011 KPM është financuar edhe për projektin kapital për ndërtimin e objektit të KPM-së në shumën prej 450,000.00 Euro. Projekti është planifikuar që të realizohet në periudhën dy vjeçare (2011 – 2012) në vlerë të përgjithshme prej 690,000.00 Euro (për vitin 2011 vlera 450,000.00 Euro dhe për vitin 2012 vlera 240,000.00 Euro sipas PIP). Prej tyre është shpenzuar shuma prej 8,120.00 Euro për Projektin Ideor sipas kërkesës së Komunës së Prishtinës.

Ky projekt nuk është realizuar për shkak se nuk është bërë ndarja e parcelës për ndërtimin e objektit të KPM-së nga Komuna e Prishtinës, prandaj mjetet e mbetura në vlerë prej 441,880.00 Euro janë kthyer në buxhet me datën 10 tetor 2011 dhe këto mjete do të shkojnë si suficit me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.12/43.

Në Shtojcën I¹² është dhënë raporti buxhetor i detajuar, i cili paraqitet edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në Ministrinë e Financave.

PJESA V

PREZANTIMI I PUNËS SË BORDIT PËR ANKESA TË MEDIAVE (BAM)

Bordi për Ankesa të Mediave (“BAM”) është organ i pavarur i themeluar në bazë të nenit 21 të Ligjit të KPM-së. Bordi i Ankesave shqyrton ankesat e palëve që drejtpërdrejt kanë të bëjnë me vendimet e Këshillit të KPM-së.

Seancat e BAM-it dhe Vendimet

Bordi për Ankesa të Mediave (“BAM”) gjatë vitit 2011 ka shqyrtuar gjithsej 3 ankesa ndaj vendimeve të Këshillit të KPM-së. BAM-i gjatë vitit 2011 ka mbajtur vetëm një seancë, më datën 24 shkurt 2011. Rastet të cilat janë shqyrtuar nga ana e BAM-it, ndaj vendimeve të Këshillit të KPM-së gjatë vitit 2011:

1. Operatori kabllor Kujtesa Net – Bordi për Ankesa të Mediave. BAM me datën 24 shkurt 2011, ka shqyrtuar dy rastet e operatorit kabllor Kujtesa Net ku ka vendosur që gjobën e shqiptuar nga ana e Këshillit të KPM-së ta reduktoj nga shuma 90 mijë Euro (nëntëdhjetëmijë euro) në shumën prej 50 mijë (pesëdhjetëmijë euro) Euro. BAM është organ i shkallës së dytë dhe vendimet e BAM janë përfundimtare. Pas shqyrtimit të Ankesave të Kujtesa Net, BAM-i ka vërtetuar Vendimet e Këshillit të KPM-së dhe në bazë të Vendimeve përfundimtare, Kujtesa Net obligohet të paguaj gjobë në vlerë prej 50 mije euro (pesëdhjetëmijë euro). Mjetet nga gjocat e shqiptuara nga KPM, inkasohen në Buxhetin e Republikës së Kosovës;
2. Ofruesi i Shërbimeve Programore Klan Kosova – Bordi për Ankesa të Mediave, BAM po ashtu me datën 24 shkurt 2011, ka vendosur për rastin Klan Kosova, BAM ka vendosur që gjobën e shqiptuar nga ana e Këshillit të KPM-së ta reduktoj nga shuma 20 mijë Euro (njëzetmijë euro) në shumë prej 10 mijë Euro (dhjetëmijë euro).

Rastet e lartpërmendura janë shqyrtuar nga ana e BAM-it gjatë vitit 2011. Duhet theksuar faktin se ky numër i vogël i rasteve të shqyrtuara nga BAM-i është rezultat i mungesës së përbërjes së plotë të organit vendimmarrës, Këshillit të KPM-së, i cili pothuajse gjatë tërë vitit 2011 ka qenë jo funksional. BAM vendos për ankesat e të licencuarve të KPM-së të cilat parashtrihen kundër vendimeve sanksionuese të Këshillit të KPM-së.

Procesi i nominimit të anëtarit të tretë të BAM-it

KPM me datën 3 maj 2011 ka bërë ftesë për nominime për anëtarë të Bordit për Ankesa të Mediave dhe gjatë procesit të hapur për nominime i cili ka përfunduar më datën 17 maj 2011, KPM ka pranuar gjithsej 4 nominime për një pozitë në BAM.

KPM me datën 19 maj 2011, përmes shkresës me nr. Ref. 1105/616/EXD/ld, ka kërkuar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës që në bazë të nenit 22 paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së të procedojë tutje me nominimet për anëtar të BAM-it.

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës duke vepruar sipas shkresës së KPM-së me nr. Ref. 1105/616/EXD/ld, me 12.07.2011 ka njoftuar KPM-në se me datën 1 korrik 2011 me shumicë votash nga radhët e kandidatëve të nominuar për anëtarë të BAM-it ka caktuar Znj. Emine Mustafa

si anëtare të BAM-it, e cila njëherësh ushtron edhe funksionin e Gjyqtares në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës.

PJESA VI

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE

Edhe në vitin 2011 Komisioni i Pavarur për Media ka vazhduar bashkëpunimin me institucionet vendore. Një bashkëpunim i tillë është ai me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ASHMDHP), ku kanë bashkë organizuar konferencën “*Media dhe Privatësia*”.

KPM dhe ASHMDHP në konferencë janë zotuar të bashkëpunojnë në mbrojtje e të dhënave personale dhe një sërë interesash tjera si mbrojtja e identitetit të të miturve, ruajtja e autoritetit të zyrtarëve si dhe mbrojtja e interesave kombëtare.

Po ashtu këto dy institucione të pavarura kanë iniciuar hartimin e një memorandumit bashkëpunimi me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve gjatë hartimit të akteve nënligjore në fushat e përbashkëta.

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE

Edhe gjatë vitit 2011, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka ofruar mbështetje teknike për KPM për organizimin e konferencës me temën “Mbrojtja e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbytjet e Dëmshme Programore” dhe ka financuar prodhimin dhe transmetimin e video-klipit për vetëdijesimin e opinionit publik për ndikimin e përmbytjeve të dëmshme programore të fëmijëve dhe të miturve. Po ashtu, me përkrahje të OSBE-së është realizuar vizita studimore e stafit të Departamentit Ligjor tek rregullatori italian AGICOM.

KPM ka vazhduar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e ndërsjellë të përvojave me EPRA, duke marrë pjesë në dy konferenca të organizuara nga Platforma Evropiane e Agjencioneve Rregullative (EPRA), anëtare e së cilës KPM është që nga viti 2003

Në nëntor të vitit 2011, KPM është pranuar me statusin e anëtarit vëzhgues në organizatën ndërkombëtare Rrjeti i Autoriteteve Rregullative të Mesdheut (MNRA), organizatë që ka për qëllim themelimin e një kornize për diskutime dhe shkëmbime të vazhdueshme të informatave dhe hulumtimeve mbi temat që kanë të bëjnë me rregullimin e fushës audio-vizuale.

SQARIM PËR SHKURTESAT E PËRDORURA

KPM - Komisioni i Pavarur për Media

ASHMDHP Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

ITU - Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit

BAM – Bordi për Ankesa të Mediave

DMA - Departamenti i Monitorimit dhe Analizave

DMF – Departamenti i Menaxhimit Frekuencor

DLIC – Departamenti i Licencimit

OK – Operatorët Kabllor

OSHP – Ofruesit e Shërbimeve Programore

PIP – Projekti për Investime Publike

EPRA – Platforma Evropiane e Agjencioneve Rregullative

MNRA – Mediterranean Network of Regulatory Authorities